



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,  
Ref:06.07.2017\564-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Nexhat Kryeziut kundër portalit të RTK-së**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Nexhat Kryeziut kundër portalit të RTK-së lidhur me artikullin "Nexhat Kryeziu i LVV-së jeton në luks, largon të varfërit nga banesat", botuar më 3 korrik 2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se procedura përmbaruese për lirimin e banesave të uzurpuara në lagjen Dardania, Llamella, SU - 9/4 hyrja 2, kati 2 dhe 3 ka filluar me 3 korrik. Ky veprim është ndërmarrë në mbështetje të vendimit të prerë të Gjykatës Komonale në Prishtinë, e jo sipas vullnetit të ankuesit.

Portali i RTK-së shkruan: "kandidati i LVV-së dhe drejtori i Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë i largoi varfënjakët nga banesat e ndërtuara në kohën e Millosheviqit".

Në ankesë poashtu thuhet se portali i RTK-së nuk e ka botuar reagimin e Ndërmarrjes Publike Banesore të dërguar më 3 korrik 2017.

KMShK, pasi shqyrtoi ankesën, artikullin, dhe reagimin e pabotuar të ankuesit, konstatoi se largimi i uzurpatorëve nga banesat është kryer me vendim të prerë të gjykatës kompetente e jo me vullnet arbitrar të Nexhat Kryeziut.

Andaj, artikulli përmban të pavërteta, dhe kështu shkel Kreun II (Raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave të Shkruara.

Gjithashtu portali i RTK-së ka pasur për detyrë, sipas Kodit të Mediave të Shkruara ta botojë reagimin e ankuesit, pas botimit të lajmit, por kjo nuk ka ndodhur. Në këtë rast është shkelur Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) të Kodit të Mediave të Shkruara.

Opinionin u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**